

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje automjeti kamioçin”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjete
34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,150,000 (Dy milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokastr** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

.....

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. **2022-2023-2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022-2023-2024** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c”, të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “c”, e ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit** të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit me shpenzimet e veta.

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës deklaron se malli i ofruar përmbush të gjitha specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ngarkojë në SPE foto të automjetit si dhe katalogun teknik të prodhimit të përkthyer dhe noterizuar të kësaj të fundit ku të jenë të evidentueshme secila prej specifikimeve të kërkuara nga ana e AK ose Leje e Qarkullimit.

2.7Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë për garancinë e automjetit për një periudhën 6 mujore nga data e dorëzimit tek AK.

Te dhenat teknike:

1.Numri I vendeve gjithse në kabine 6 + 1 vende

2.Karburanti i përdorur: Gazoil (Nafte)

3.Fuqia 95- 130 kw (2143cm³ deri në 3000 cm³)

4.Kapaciteti bruto 3500 -5000 kg

5.Pesha neto 2275-3490 kg

-Ngarkesa e dobishme 1.225-1510 kg

Karroceria /superstruktura

-Gjatesia e ngarkeses 3200-3430mm

-Gjeresia e ngarkeses 1900-2050 mm

-Lartesia e ngarkeses 400 -600 mm

-Konfigurimi I aksit 4x2 (dopjogome aksi I pasem)

6.Viti i prodhimit : Jo me pare se viti 2014 e larte)

7.Kambio : Manuale

8.Numri I dyerve: 4

9.Numri I cilindrave : 4

10.Makina te kete pershkuare jo me shume se 180.000-220.000 km origjinale.

11. Opsionet e makines :

- Kondicioner me klima ,funksional.

-xhamat elektrik dhe mekanik

-ABS

- Gomat te mos jene te konsumuara me shume se 20%

12.Sistemet baze te mjetit te jene funksionale dhe pa problem:

-sistemi I drejtimit

-sistem frenimi

- sistemi I trasmesionit kardanik.

-Sistemi pamore dhe zanor

13.Klasa e shkarkimit te gazeve,sipas legjislacionit ne fuqi.

14. Norma e emetimit: Minimalishtë Euro 5

- Automjeti duhet te jete i pajisur me dokumentacionin ligjor në momentin e dorzimit si me poshtë:

1. Leje qarkullimi
2. Targe
3. Akte kolaudimi (te vlefshme te leshuara ne republiken e shqiperis)
4. Certificate pronesie ne emer te ofertuesit.
5. Siguracion(e vlefshme në datën e dorzimit)

15.Automjeti do te merret ne dorzim nga investitori (Bashkia Gjirokaster) me komision te posacem.

16.Ne momentin e dorzimit te jene shlyer te gjitha detyrimet, taksa ,gjoba e detyrimet te tjera ligjore n.q.se ka.

17.Dorzimi i Automjetit do te kryhet nga kontraktuesi me shpenzimet e veta ne adresen e autoritetit kontraktor.

18.Te gjitha shpenzimet e mesiperme dp te perfshihen ne cemimin e ofertes.

19.Automjeti do te kete garanci difektesh per nje perjudhe 6 (gjashte) mujore nga dita e dorzimit tek investitori dhe shitesi do te pergjigjet per riparimin e difekteve jo me vone se tre dite nga data e njoftimit.

20.Difektet te cilat perfshin perjudha e garancise jane si me poshte:

- difekte motorike
- difekte te kutise se shpejtesise
- difekte te trasmesionit
- difekte te paketave elektrike
- difekte te sistemit hidraulik

21.Percaktimi i shkakut te difektit do te kryhet nga nje ekspert i miratuar me pelqimin e paleve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSI E PROKURIMIT

Alma Llace

Lorjana Shehu

Alfons Alikaj